

PROCES – VERBAL -- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar me destinacion Madrid”.

Kodi Përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 34980000- 0

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **ALBCONTROL SHA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E PËRGJITHSHME / VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- 1.1** Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit si dhe kodin e llogarisë së klientit.
- 1.2** Operatori ekonomik quhet të paraqesë ekstraktin e regjistrit historik dhe tregtar lëshuar nga QKB, ku aktiviteti tregëtar të jetë objekt i kësaj procedure.
- 1.3** Çertifikatë akreditimi ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga IATA.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Udhëzim nr. 03 Datë 18.06.2021 ”Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike” si dhe bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2 ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, duke marrë në konsideratë karakteristikat dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. si dhe nenit 41 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Specifikimet teknike dhe interneraret e fluturimeve janë detajuar sipas Ftesës për Ofertë.
- * *Sqarim: Në rastet e fluturimeve me tranzit preferohet që koha tranzite të jetë mbi 2 orë për shkak të procedurave dhe postobloqeve e nyjeve të shtuara të kontrollit përsa i përket masave dhe protokolleve antikovid që ushtrohen në aeroporte.*

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.